

VENDIM
Nr. 562, datë 29.7.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 367, DATË 30.5.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE TË
HOLLËSISHME DHE INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE PËR NDALIMIN E
PËRDORIMIT, HEDHJES NË TREG, PRODHIMIT, IMPORTIMIT APO FUTJES
NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË QESEVE PLASTIKE
MBAJTËSE, SI DHE QESEVE PLASTIKE MBAJTËSE TË OXO-DEGRADUESHME
APO OXO-BIODEGRADUESHME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 29, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 367, datë 30.5.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përcaktimin e masave të hollësishme për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, me trashësi të mureve të qeses për çdo anë më të vogël se 70 (shtatëdhjetë) mikronë, me kapacitet mbajtës më të vogël se 10 (dhjetë) kilogramë dhe me përmasa më të vogla se 50 (pesëdhjetë) cm gjatësia dhe 24 (njëzet e katër) cm gjerësia, pa përfshirë gjerësinë e palosjeve, si dhe të qeseve plastike mbajtëse të *oxo*-degradueshme apo *oxo*-biodegradueshme, nga subjektet, sipas parashikimeve të këtij vendimi, nga data 1 qershor 2022.”.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Për qëllim të këtij vendimi, fjalët “import” dhe “futja në territorin e Republikës së Shqipërisë” kanë këtë kuptim:

a) “**import**”, vendosja e mallrave në regjimin “çlirim për qarkullim të lirë”, në përputhje me përcaktimet e shkronjës “a”, të pikës 16, të nenit 6, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) “**futje në territorin e Republikës së Shqipërisë**”, futja e mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e neneve 266 e 267, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.”.

3. Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronjat “a” dhe “b” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Mbikëqyr dhe kontrollon, nëpërmjet kontrollit dokumentar e fizik, subjektet që përdorin dhe/ose i ofrojnë konsumatorit gjatë veprimtarisë tregtare qeset plastike mbajtëse, sipas kriterëve ligjore të përcaktuara në këtë vendim, dhe kontrollon ndalimin e përdorimit të qeses plastike mbajtëse të *oxo*-degradueshme dhe *oxo*-biodegradueshme;

b) Inspekton me mjete të certifikuara për verifikimin e parametrave të trashësisë së mureve të qeses plastike gjatësinë e gjerësinë e qeses plastike, pa përfshirë pjesën e palosjes, sipas përmasave të përcaktuara në këtë vendim, si dhe verifikon sistemin e shënjitimit.”.

b) Në shkronjën “c”, fjala “... inspekton ...” zëvendësohet me “... kontrollon ...”.

4. Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

a) Fjala hyrëse e pikës 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucioni përgjegjës për zbatimin e masave të hollësishme për ndalimin e prodhimit të qeseve plastike mbajtëse, sipas parashikimeve të pikës 1, të këtij vendimi, si më poshtë vijon: ...”;

b) Shkronjat “a” dhe “c” ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) Organizon dhe zhvillon fushata ndërgjegjësuere për ndalimin e prodhimit, përdorimit, importit dhe futjes së qeseve plastike mbajtëse, sipas kritereve ligjore të përcaktuara në këtë vendim, dhe ndalimin e prodhimit, përdorimit, importit dhe futjes së qeses plastike mbajtëse të *oxo*-degradueshme dhe *oxo*-biodegradueshme;

c) Inspekton dhe kontrollon subjektet, që prodhojnë qese plastike për përmbushjen e kritereve të prodhimit, sipas përcaktimeve të pikës 1 dhe aneksit 1, të këtij vendimi”;

c) Nënndarja “iv”, e shkronjës “e”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“iv. prodhuesit e qeseve plastike mbajtëse si dhe sasinë e qeseve plastike mbajtëse të prodhuara në muaj dhe subjektet të cilat tregtohen për qëllime përdorimi qeset e prodhuara.”.

5. Në pikën 6 bëhen këto ndryshime:

a) Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është struktura kryesore përgjegjëse për ndalimin e importimit (çlirim për qarkullim të lirë) apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike sipas pikës 1, të këtij vendimi, duke marrë masat e hollësishme, si më poshtë vijon: ...”;

b) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) mbikëqyrjen dhe kontrollin e personave/subjekteve, që importojnë apo fusin në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike mbajtëse, me trashësi të mureve të qeses për çdo anë më të vogël se 70 (shtatëdhjetë) mikronë, me kapacitet mbajtës më të vogël se 10 (dhjetë) kilogram dhe me përmasa më të vogla se 50 (pesëdhjetë) cm gjatësia dhe 24 (njëzet e katër) cm gjerësia, pa përfshirë gjerësinë e palosjeve, si dhe ndalimin e importit të qeseve plastike mbajtëse të *oxo*-degradueshme dhe *oxo*-biodegradueshme”;

c) Në shkronjën “b” hiqen fjalët “... dhe qeses plastike të *oxo*-degradueshme apo *oxo*-biodegradueshme ...”;

ç) Në shkronjën “c” hiqen fjalët, “... qeset plastike të *oxo*-degradueshme dhe të *oxo*-biodegradueshme ...”;

d) Në shkronjën “ç” bëhen këto ndryshime:

i. Fjalët “... të vendosjes së gjobës dhe sekuestrimit të qeseve plastike, të ndaluara ...” zëvendësohen me “... sipas legjislacionit në fuqi ...”;

ii. Fjalët “... Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe ...” hiqen.

6. Në pikën 7 hiqen fjalët “... dhe qeses plastike të *oxo*-degradueshme apo *oxo*-biodegradueshme”.

7. Pas pikës 8, shtohet pika 8.1, me këtë përmbajtje:

“8.1. Për zbatimin e këtij vendimi krijohet Task-Forca për qeset plastike mbajtëse. Përbërja, mënyra e organizimit dhe funksionimit përcaktohet me urdhër të Kryeministrit.”.

8. Në pikën 9 hiqen fjalët “... sekuestrimin dhe riciklimin ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama